



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS I.**

---

Numri i lëndës: 2022:086801  
Datë: 31.05.2022  
Numri i dokumentit: 03081102

**PPP.nr.17/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA I.**, si përmbarimore e përberë nga Gjyqtari individual Blerim Istrefi, ne çështjen juridike të kreditorit KRM A... SH.A Njësia Operative I., kundër debitorit K... SH.A me seli në fsh G. K-I., për shkak të borxhit në shumë prej 1,186.83 €, pas prapësimit te ushtruar nga ana e debitori, me dt. 02.03.2022 kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, gjykata jashtë seance me dt.31.05.2022 nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**HEDHET POSHTË** prapësimi i debitorit: K... SH.A me seli në Fsh G. K-I., ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.289/2021 të dt.30.12.2021, për shkak të borxhit në shumë prej 1,186.83 €, si i PA AFATSHËM.

**A r s y e t i m**

Kreditori, KRM A... SH.A Njësia Operative I. ka ushtruar propozimin për përmbarim te përmbaruesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përmbarimi ndaj debitorit K... SH.A me seli në fsh G. K-I., për borxh në shumë prej 1,186.83€, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, të gjitha këto në afat 7 ditor nga pranimi i urdhrit, në të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarive bankare të debitorit, sekuestrimi regjistrimi dhe shitja e sendeve te luajtshme dhe te paluajtshme, e shuma e mjeteve të transferohet në llogari te kreditorit, të gjitha të specifikua në propozimin për përmbarim të datës 30.12.2021.

Përmbaruesi privat me urdhër P.nr.289/2021 të dt.30.12.2021, e ka lejuar propozimin për përmbarim.

Pas lejimit të përmbarimit me urdhër përmbarimor, të njëjtin përmbaruesi privat ja ka dorëzuar debitorit të cilin e ka pranuar me datë 22.02.2022 me paralajmërimin se pala e pakënaqur ka të drejt të paraqes prapsim në afat 7 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit.

Debitori, K... S.H.A me seli në fsh G. K-I., ka ushtruar prapsim me dt:02.03.2022 kundër urdhrit për përmbarim përmbarimit P.nr.289/2021 të dt.30.12.2021, me te cilën është lejuar përmbarim sipas propozimit të kreditorit kreditorit KRM A... S.H.A Njësia Operative I..

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se debitori, nuk ka vepruar brenda afatit ligjor të përcaktuar për paraqitjen e prapsmit kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, andaj gjykata, bazuar ne nenin 70 te Ligjit të Procedurës Përmbarimore i cili thotë citoi “Prapësimi duhet ti paraqitet gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrit përmbarues” e në rastin konkret debitori K... S.H.A me seli në fsh G. K-I. e ka pranuar propozimin për përmbarim të lejuar me urdhër me datë 22.02.2022 dhe afati ka filluar të ecë nga data 23.02.2021 ndërsa prapësimin e ka parashtruar me datë 02.03.2022, e nga pranimi i propozimit të përmbarimit e deri me ditën e paraqitjes së prapësimit kanë kaluar 8 ditë, e në rastin konkret afati i fundit për ngritjen e prapësimit ka qenë data 01.03.2022, ashtu që prapësimi i debitorit konsiderohet si I PA AFATSHËM.

Andaj, nga të lartcekurat e duke u bazuar në nenin 70, 73.3 të LPP-së (Ligjit të Procedurës Përmbarimore), u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA I.**  
**PPP.nr.17/2022, dt.31.05.2022**

**GJYQTARI**  
Blerim Istrefi

**UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.